



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.4.2023

Nr: 333

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË SUBJEKTIT
VETËDEKLARUES Z. ADRIATIK KADRI SALLAHU, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN
BASHKIAK, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA ALEANCA ARBNORE
KOMBËTARE" PËR BASHKINË TROPOJË**

Sot më datë 12.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Adriatik Kadri Sallahu, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Aleanca Arbnore Kombëtare" për Bashkinë Tropojë.

Baza ligjore: Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 5 dhe 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut II, III, V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin

Data: 12.4.2023 Nr: 333
Ora: 12:00



Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Adriatik Kadri Sallahu, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Aleanca Arbnore Kombëtare", për Bashkinë Tropojë.

për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe kandidati për kryetar bashkie apo anëtarë në këshillat bashkiak.

Me vendim të KZAZ-së z. Adriatik Kadri Sallahu, është regjistruar si kandidat për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Tropojë, i mbështetur nga subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Arbnore Kombëtare”.

Për këtë kandidat në datën 30.3.2023, pranë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është depozituar formulari e vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik KU-AAK-10386. Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPGJ).

Në përgjigje të kësaj kërkesë të Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, DPGJ informon se kandidati në fjalë nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Adriatik Kadri Sallahu, rezulton:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se nuk ka ndryshim tek gjeneralitetet e tij;
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, Pyetjes 1 “ A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj? subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se është dënuar nga Gjykata e qytetit të Subotica në vitin 2003 me masën e dënimit 40 ditë burgim , akuzuar për veprën penale të kalimit të paligjshëm të kufirit;
- Subjekti ka deklaruar se është dënuar nga Gjykata e Amsterdemit në vitin 2012 me masën e dënimit 60 ditë burgim, akuzuar për veprën penale të tentimit të paligjshëm të kufirit.
- Pyetjes 3 “ A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se është proceduar nga Gjykata e qytetit Subotica në Serbi, akuzuar për veprën penale të kalimit të paligjshëm të kufirit, me masën e dënimit 40 ditë burgim në vitin 2003;
- Subjekti ka deklaruar se është dënuar nga Gjykata e Amsterdemit në vitin 2012 me masën e dënimit 60 ditë burgim, akuzuar për veprën penale të tentimit të paligjshëm të kufirit;
- Pyetjes 4 “A keni qenë ndonjëherë I ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale? subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se është proceduar nga Gjykata e qytetit Subotica në Serbi, akuzuar për veprën penale të kalimit të paligjshëm të kufirit, me masën e dënimit 40 ditë burgim në vitin 2003;
- Subjekti ka deklaruar se është dënuar nga Gjykata e Amsterdemit në vitin 2012 me masën e dënimit 60 ditë burgim, akuzuar për veprën penale të tentimit të paligjshëm të kufirit
- Pyetjes 5 “ A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale , në fuqi apo jo?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se është proceduar nga Gjykata e qytetit Subotica në Serbi, akuzuar për veprën penale të kalimit të paligjshëm të kufirit, me masën e dënimit 40 ditë burgim në vitin 2003.

- Subjekti ka deklaruar se është dënua nga Gjykata e Amsterdemit në vitin 2012 me masën e dënimit 60 ditë burgim, akuzuar për veprën penale të tentimit të paligjshëm të kufirit
- Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se ka qëndruar si emigrant në Bruksel, të shtetit Belg, 2 deri në 3 muaj qëndrimi me adresë “Qyteti Bruksel, Nord”;

Në vlerësim të përmbajtjes së deklaramëve si më sipër në formular, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se është e nevojshme marrja e informacioneve shtesë në lidhje me faktet që lidhen me autoritete dhe vende të huaja. Në nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 3, shkronja “b/ii”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015”, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklaramëve të bëra.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Adriatik Kadri Sallahu kandidat për anëtar në këshillin bashkiak i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Arbnore Kombëtare” për Bashkinë Tropojë dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI